

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtim i godinës së shkollës Goriçan”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV31681410-0;
39293300-5; 44112310-4; 44115200-1; 44221000-5; 45111230-9; 45112000-5; 45261420-4; 45262300-
4; 45262340-6; 45321000-3; 45410000-4; 45442100-8; 45443000-4; 51700000-9**

VLERA E FONDIT LIMIT: 70 833 333,33 (shtatëdhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e
treqind e tridhjetë e tre presje tridhjetë e tre) lekë pa tvsh

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020“Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe
Nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit
Publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Dimal, ka hartuar procesverbalin për argumentimin
dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar,
me përmbajtjen si më poshtë

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Lista e Çmimeve sipas Zërave Të Preventivit, **sipas** Shtojcës 2;
- c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- ç. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas *shtojcës 8 të DST*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim për deklarinimin e xhiros vjetore, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (2020, 2021, 2022), në të cilat duhet të rezultojë se vlera e xhiros minimale vjetore të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet (vlera e kontratës që prokurohet).

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :

- vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, bazuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet **financiare 2020, 2021, 2022** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009, neni 41, pika “c”, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku

bilancet e dy viteve, kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. AK mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve, është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë: 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 5, datë: 30. 01. 2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit nr. 29, të ligjit nr. 8438, datë: 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: Çdo tatim-pagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatim-paguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast vetëdeklarimi të rremë do të vepohet në përputhje me Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Dimal, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik

Për sa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës se përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundi, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
Dhe /ose
- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpallje së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in si dëshmi, vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, të DST,
 - Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Fatura tatimore.

- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori/t Ekonomik duhet të paraqesë/in si dëshmi, vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohet vlera, afati i përfundimt të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit shoqëruar me faturën;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Fatura tatimore
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.

1.3 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.

1.4 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. “Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi,ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. “Njësia përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacioneve ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998

“Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së nr. 285 datë:19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të kësaj VKM-je, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike, për të pasur mundësi të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktor edhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Meqenëse se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.3 Operatori Ekonomik, duhet të vetëdeklarojë (sipas Shtojcës 8 të DST), se disponon fuqinë minimale punëtore jo më të vogël se 60 (gjashtedhjetë) punonjës me kohe të plote, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit për periudhën **Prill 2023 - Qershor 2023**.

Për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet që, nga operatori ekonomik të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën **Prill 2023 - Qershor 2023**.
- b) Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.**

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit të lartpërmendur

Argumentimi; Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 60 (gjashtedhjetë) punonjës me kohe të plote, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të

punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e lartë të punimeve.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

2.3.4 Operatorët Ekonomike, duhet të disponojnë liçensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë, duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i liçensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Liçensa profesionale e Operatorit Ekonomik, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës dhe duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1-A	Punime gjërmimi në tokë
2	NP-2-D	Ndërtime civile dhe industriale
3	NS-1-A	Punime për prishjen e ndërtimeve
4	NS-2-A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
5	NS-4-A	Punime rifiniture dhe të lidhura me to, ...;
6	NS-8-A	Ndërtime parafabrikat, b/a, struktura metalike dhe druri;
7	NS-12-A	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
8	NS-14-A	Impiante të brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni TV, etj.
9	NS-18-A	Punime topogjeodezike

*Operatorët e huaj, duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës), Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, date 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit 162, datë: 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42, datë: 16. 01. 2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, (lidhja 2,3 dhe 4).

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **N.P - 1 A** Punime gjurmimi në tokë;

Argumentimi Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.

- **N.P - 2 D** Ndertime civile e industriale

Argumentimi Konsiderohen ndertime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtëpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavanëve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndertime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **N.S - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve

Argumentimi Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

- **N.S - 2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;

Argumentimi Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

- **N.S - 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;

Argumentimi Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese. Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të

ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

N.S - 8 A Ndërtime parafabrikat, b/a, struktura metalike dhe druri;

Argumentimi Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantjer dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.

• **N.S - 12 A** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;

Argumentimi Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

• **N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

Argumentimi Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

• **N.S - 18 A** Punime topogjeodezike.

Argumentimi Konsiderohet zbatimi i riveimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Klasifikimi i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

NIVELI I SHOQËRISË	SIPAS VLERAVE NË LEKË TË PUNIMEVE TËKRYERA PËR ÇDO KATEGORI PUNIMI
---------------------------	---

A (edhe për herë të parë)	0- 20 milion lekë
B	21- 50 milion lekë
C	51 – 100 milion lekë
D	101 – 200 milion lekë
E	201 – 400 milion lekë
F	401 – 800 milion lekë
G	mbi 800 milion lekë

2.3.5 Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet.

2.3.5/1 Operatori/ët ekonomike ofertues duhet të paraqesë/in me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 në DST:

Se disponon në stafin e tij si Drejtues Teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

1. Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
2. Inxhinier Elektronik	1 (një)
3. Inxhinier Gjeodet	1 (një)
4. Inxhinier Mekanik	1 (një)
5. Arkitekt	1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar, duhet të figurojnë si **drejtues teknik në licensën** e Operatorit Ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë minimumi për periudhën **Prill 2023 - Qershor 2023**.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Bazuar ne **UKM nr.2 date 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”**, pika 1.2 Drejtuesit ligjorë dhe teknikë të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu bazuar ne po kete udhezim Pika 4.1 Drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij. Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier. Nisur nga fakti që kemi kërkuar licencat e shoqërisë sipas pikes 2.3.3/1, atehere keto licenca kane detyrim drejtuesin teknik te firmes sipas specialitetit perkates.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar-drejtues teknike është përcaktuar në vijim te Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në

bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar drejtues teknike sipas pikës 2.3.5, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Eshte kërkuar inxhinier ndërtimi i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet, për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve të betonit të pranishme në preventiv si: ndërtim mure betoni, pusetat beton arme, puseta shpërndarje dhe pusetat e kontrollit etj

Eshte kërkuar inxhinier elektronik i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet, për secilin nga zërat e punimeve elektronike, referuar preventivit e të punimeve.

Eshte kërkuar gjeodet, pasi sipas relacionit teknik dhe specifikimeve teknike, është parashikuar se kontraktori që do të marrë përsipër zbatimin e objektit inxhinierik, duhet të bëjë dendësimin e pikave të bazamentit, duke realizuar vlerat e paracaktuara të dhëna në specifikimet teknike të objektit, në lidhje me saktësinë e realizimit të piktimit. Nga shoqëria kërkohet dhe një azhornim i saktë i këtij investimi në përfundim.

Eshte kërkuar inxhinier mekanik i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet, për secilin nga zërat e punimeve mekanike, referuar preventivit e të punimeve.

Eshte kërkuar arkitekt i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet, për secilin referuar preventivit e të punimeve.

Për inxhinierët, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë:

- Kontratat e punës (të vlefshme);
- Diplomat përkatëse;
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë minimumi për periudhën **Prill 2023 - Qershor 2023**.

2.3.5/2 Operatori pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmerisht të perfshire në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplome, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajt **Prill 2023 - Qershor 2023**, si më poshtë:

- | | |
|--|---------|
| 1. Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| 2. Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| 3. Inxhinier Ndertimi - Profili Gjeoteknik | 1 (një) |

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit

26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin teknik mbeshtetes , lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve

2.3.5/3 Operatorët ekonomik pjesëmarres të kenë në stafin e tyre min. 2 (dy) punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për këta specialistë të paraqiten kontrata e punës, diploma dhe çertifikata përkatëse e dhënë nga një organizëm i licencuar shqiptar ose i huaj si dhe të figurojnë në listpagesat për periudhën **Prill 2023 - Qershor 2023**.

Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështet në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, te Ligjit nr.124/2015 “Për efincencën e energjisë”.

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit

2.3.5/4. Operatori ekonomik duhet të deklarojë (*sipas shtojcës 8 të DST*) se ka minimumin punonjës specialist për kryerjen e punimeve, dhe të figurojnë në listpagesat për periudhën **Prill 2023 - Qershor 2023**, si më poshtë:

2 (dy) Teknik ndertimi shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

1 (një) Teknik hidroteknik shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

1 (një) Teknik mekanik shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

2 (dy) Punonjës elektrikist shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

2 (dy) Punonjës hidraulik shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione

publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

1 (një) Punonjës saldator shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

2 (dy) Punonjës bojaxhi shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

4 (katër) Muratorë shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

4 (katër) Suvatues shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

4 (katër) Karpentier shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

4 (katër) Hekurkthyes shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

2 (dy) Punonjës hidroizolues shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

2 (dy) Punonjës pllakashtrues shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

2 (dy) Punonjës duralumini shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

2 (dy) Punonjës në lartësi shoqëruar me kontratë pune (të vlefshme) dhe diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

11 punetore te thjeshte ndërtimi, per te cilët te paraqite kontrata e punës si dhe te figurojnë ne listepagese minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemri i punonjësit	Profesionit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. NIPT(Në rast se lëshuesi është institucion privat)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar gjithashtu duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur Autoriteti Kontraktor në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

- **Teknik ndërtimi**, të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, duke pasur parasysh punime ndërtimore që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve, mur tulle për puseta, bordura betonarme etj.
- **Teknik hidroteknik**, të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve hidroteknike, duke pasur parasysh punime hidraulike dhe hidroteknike që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
- **Teknik mekanik**, të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve mekanike, duke pasur parasysh punime mekanike që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
- **Punonjësit saldatorë** janë kërkuar për kryerjen e të gjitha punimeve që kanë të bëjnë me saldimit drejtimin bashkimin e detaleve të ndryshëm me prerjen e tyre me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura sipas zërave të preventivit të punimeve. Këto përcaktime janë bërë edhe në specifikimet teknike të publikuara në SPE.
- **Hidraulikë**, të cilët siç parashtrua më lart, janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e të gjitha punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Konkretisht: Në specifikimet teknike, parashikohet furnizim vendosje i tubave përfshirë të gjithë mbështetësit, rakorderitë dhe mbrojtjet, pajisje shtesë për shtrimin. Cilësia e Instalimit varet në një masë të madhe nga personeli që do të bëjë këtë bashkim, dhe respektimi prej tyre i kërkesave teknike. Për këtë arsye, specialistët që do të punojnë për bashkimin e tyre,

duhet të jenë të pajisur me certifikatën përkatëse për punimet hidraulike, e cila do të vërtetojë kualifikimin dhe trajnimin e tyre.

- **Specialistët hidroizolues** janë kërkuar duke pasur parasysh volumin e hidroizolimit në procesin e hidroizolimit.
- Punonjës **hekurkthyes** janë kërkuar për të realizuar kthimet e hekurit, kornizat e hekurit në armaturat e betonit në punimet e betonit. Këta punonjës realizojnë kthimet e hekurit, kornizat e hekurit në armaturat e betonit në punimet e betonit dhe shtresë betoni. Specialistët hekurkthyes presin, përkulin dhe vendosin rrjeta teli në strukturat e betonit, bëjnë planet e punës në lidhje me strukturat e hekurit dhe betonit, përgatitin shufra çeliku ose rrjeta çeliku me gjatësinë e kërkuar duke i prerë ato me mjetet përkatëse, mbledhin shufrat ose rrjetat përforcuese duke salduar, instaluar në tokë ose prerë në vende të paracaktuara brenda betonit, fabrikojnë struktura çeliku dhe vendosja e tyre si strukturë për derdhjet e betonit, etj.
- **Specialistët karpentier dhe murator** janë kërkuar për të realizuar punimet e armaturave në beton duke pasur parasysh volumin e punimeve me hekur beton (referuar preventivitet). Është e nevojshme për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri, si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.
- **Specialistët suvatues** janë kërkuar për të realizuar punimet e suvatimit duke pasur parasysh që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
- **Specialistët duroalumini** janë kërkuar për të realizuar punimet e vendosjes së dyerve dhe dritareve duke pasur parasysh që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
- **Specialistët elektrikist** janë kërkuar për të realizuar punimet elektike duke pasur parasysh që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
- **Specialistët bojxhi** janë kërkuar për të realizuar punimet e bojatisjes duke pasur parasysh që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
- **Specialistët punime në lartësi** janë kërkuar për të realizuar punimet që realizohen në lartësi dhe kërkojnë një trajnim të vecantë duke pasur parasysh që do të kryhen sipas zërave të preventivave të punimeve.
- **Punetoret e thjeshtë**, janë kërkuar për realizimin e punimeve të thjeshta që nuk kërkojnë njohuri specialitetesh.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë (*sipas shtojcës 8 të DST*) se ka të punësuar punonjës me dëshmi e aftësi profesionale për përdorimin e makinerive të renda të ndërtimit dhe punimeve në tokë miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe referuar Kodit Rrugor si më poshtë:

Automakinistë 3 (tre) me kontratat e punës (të vlefshme), dëshmi e aftësi profesionale për përdorimin e makinerive të renda të ndërtimit dhe punimeve në tokë D.A.P (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Prill 2023 - Qershor 2023**.

Ekspertët 2 (dy) me kontratat e punës (të vlefshme), dëshmi e aftësi profesionale për përdorimin e makinerive të renda të ndërtimit dhe punimeve në tokë D.A.P (të vlefshme), lëshuar

nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per **Prill 2023 – Qershor 2023**.

Shoferi Kamioni 4 (kater), me kontratat e punës (të vlefshme), leje drejtimi minimalisht kategoria C (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per **Prill 2023 - Qershor 2023**.

(Në rastin kur punonjësit Manovrator dhe dy drejtues mjetesh janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në pikën 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

2.3.7 Operatori ekonomik, duhet të ketë të paktën minimalisht **1 (një) punonjës**, në stafin i tij, që të disponojë dëshmi trajnimi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten, certifikata e trajnimit për **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”**, e dhënë nga një organizëm i licencuar, kontrata e punës, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **Prill 2023 - Qershor 2023** (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të paraqese 1 (një) punonjës **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** ne përputhje me perqindjen dhe/ose natyre e pjesëmarrjen ne pune, shërbim apo furnizim, te percaktuara ne aktëmarreveshje).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit.

Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes

2.3.8 Operatorët ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve.

Argumentimi. *Ne baze të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me anë të këtij kriteri AK gjykon se disponimi në pronesi apo me qera i ketyre fabrikave është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kerkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i garantuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të ketyre mallrave që do të perdoren në punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njëkohsisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kerkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kerkuara në DST. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtperdrejte me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pasi sasia e produkteve që do të perdoren është e konsiderueshme.*

2.3.9 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar të paktën një ekspert zjarrfikës i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Prill 2023 – Qershor 2023**, vertetuar me kontratë pune dhe leje/certifikate ushtrimi profesioni. Operatorët ekonomik ose ekspert zjarrfikës duhet të jete i pajisur me licence për mbrojtje nga zjarri, të leshuar nga QKL, Kodi I.2.A.

Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 77, pika 4 si dhe në VKM-në nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 39, pika 6/c. në Ligjin Nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" Kjo kërkesë vendoset referuar zërave të punimeve elektrike dhe mekanike, Gjithashtu, referuar dhe të dhënave të projektit si dhe specifikimeve teknike, personi përgjegjës për, duhet të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, të informojë dhe këshillojë stafin teknik dhe profesionalë.*

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues minimumi për muajt **Prill 2023 – Qershor 2023**, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licencuar, sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh

ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekesore për stafin e tyre, nëpërmjetë punesimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

2.3.11 Operatori Ekonomik të ketë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve te ngurta, inerte”. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve te ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjisllacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25, se bashku me aktin e miratimit ku minimalisht te perfshihen kodet **17 05 04** dhe **17 09 04**.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në shtojcën 1/B eshte listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.12 Operatori Ekonomik duhet të ketë 1 (nje) inxhinjer si “Ekspert” për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në përputhje të Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”. Per kete duhet te paraqitet diploma, kontrata individuale e punës si dhe certifikata për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis te lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anetari qe do te kryeje punimet e perkatëse.

Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik të cmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike të tyre” bazuar në përlogaritjen e oreve të punës, kategorite e punimeve të percaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zerave të punimeve, të cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik të kerkuar nga AK, si edhe bazuar në dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt të objektit.

2.3.13 Inxhinier – Auditues energjie 1 person (i pajisur me “Certifikate për auditimin e energjise),
Për inxhinierin e eficenses se energjise duhet të ketë këto dokumenta provues:

- Kontrata noteriale e punës (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të ndertimit),
- Te ketë diplome universitare profili inxhinieri.
- Certifikata / Diploma për eficensen e energjise të jete në listepagesen për periudhën **Prill 2023 – Qershor 2023**.

Ky kusht do të plotësohet nga operatorit Ekonomik tek formulari i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetëdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim: Ligji nr.124/2015 “Për eficientësin e energjisë” përcakton se “Auditim energjitik” është procedura që ndiqet për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për profilin ekzistues të konsumit të energjisë së një ndërtese ose një grupi ndërtesash, të një objekti dhe/se instalimi privat, me qëllim identifikimin dhe përlogaritjen e kostove dhe kursimeve të energjisë, raportimin e rezultateve dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të eficientësisë së energjisë. “Përmirësimi i eficientësisë së energjisë” është rritja e eficientësisë në përdorimin fundor të energjisë, si rezultat i ndryshimeve teknologjike dhe /ose 8 sjelljeve ekonomike. Auditimet energjitike të detyrueshme kryhen: b) çdo herë përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objekte të tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm. operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të ketë një auditues energjie me qëllim mbledhjen e të dhënave të nevojshme për konsumin e energjisë

në objektin që do rikonstruohet, identifikimin dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të efikasitetit të energjisë.

Në nenin 9 pika 1 të ligjit nr.124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” parashikohet se: “Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përfshin në rregullat e prokurimit publik parashikime, të cilat detyrojnë autoritetet kontraktore që të përcaktojnë në dokumentet e procedurave të prokurimit të pajisjeve apo produkteve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë, specifikime teknike, që përmbushin kërkesat minimale të efikasitetit të energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”

2.4 Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qera; Dëshim për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Operatori/ët ekonomik, të vetëdeklarojnë sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (*shtojca 8*), për mjetet dhe pajisjet si më poshtë:

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
3.	Kamioncina me kapacitet mbajtës 1.5 deri 5 ton	Në pronësi ose me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	3
4.	Eskavator me goma (me targa) (MT)	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
5.	Kamion me vinç me kapacitet mbajtës 4 deri 8 ton	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
6.	Rimorkiator për transportin e mjeteve me kapacitet mbajtës mbi 12 ton	Në pronësi, me qera ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
7.	Fadromë kovë para dhe mbrapa (me targa) (APV)	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
8.	Eskavator me zhinxhir + cekic	në pronësi ose me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
9.	Minieskavator	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
10.	Rul gome-hekur ngjeshës mbi 9 ton	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
11.	Autobetoniere	Në pronësi, me qera ose kontratë bashkëpunimi	Copë	3
12.	Autopompë	Në pronësi, me qera ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1

13.	Gjeneratorë = dhe/ose mbi 50 kva	Në pronësi/me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
14.	Betoniere kantjeri 0.25 m ³	Në pronësi, me qera ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
15.	Vibrator betoni	Në pronësi, me qera ose kontratë bashkëpunimi	Copë	3
16.	Matrapik per prishje	Në pronësi ose me qera	Copë	2
17.	Depozita Uji 5000 L	Në pronësi ose me qera	Copë	1
18.	Nivelues/Helikopter betoni	Në pronësi, me qera ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
19.	Kthyesë Hekuri-Bango hekuri	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
20.	Kontenjer (zyre)	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
21.	Elektro saldatrëçe	Në pronësi ose me qera	Copë	1
22.	Skela	Në pronësi ose me qera	M2	1800
23.	Armaturë/betoforma/lendë drusore	Në pronësi ose me qera	M2	1000
24.	Prerëse plakash	Në pronësi ose me qera	Copë	2
25.	Gazogjen	Në pronësi ose me qera	Copë	2
26.	Pompë suvatimi	Në pronësi ose me qera	Copë	2
27.	Platformë ngritëse për lartësi	Në pronësi ose me qera	Copë	1
28.	Damper kantieri	Në pronësi ose me qera	Copë	1
29.	Greider me targa (MT)	Në pronësi ose me qera	Copë	1
30.	Impiant prodhim betoni me QKL	Në pronësi, me qera, ose kontratë furnizimi	Copë	1

Ky dokumentacion, përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas *Shtojcës 8 të DST-së*.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

A. Për mjetet në Pronësi që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Leje qarkullimi, (të vlefshme), lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, (të vlefshme), lëshuar nga D.P.SH.T.RR (e vlefshme).
3. Policë për sigurimin e detyrueshëm ndaj palëve të treta (T.P.L.), (të vlefshme), lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar (e vlefshme).
4. Çertifikata e transportit lëshuar nga Bashkia ose D.P.SH.T.RR (e vlefshme).

B. Licence per transport mallrash per te trete dhe me qira brenda vendit (e vlefshme) :

C. Për mjetet me Qera që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten

1. Leje qarkullimi, (të vlefshme), lëshuar nga D.P.SH.T.RR.

2. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, lëshuar nga D.P.SH.T.RR (e vlefshme).
3. Policë për sigurimin e detyrueshëm ndaj palëve të treta (T.P.L.), (të vlefshme), lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar (e vlefshme).
4. Kontrata përkatëse e qirasë, (e vlefshme).
5. Çertifikata e transportit për të tretë ose në emër të qeramarrësit lëshuar nga Bashkia ose D.P.SH.T.RR (e vlefshme).

D. Për mjetet në Pronësi që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Fatura tatimore e blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara.

E. Për mjetet me qera që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Fatura tatimore të blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara;
2. Kontrata përkatëse e qirasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.
3. Për impiantin e prodhimit të betonit të paraqiten dokumentat e pronësisë ose kontrtën e qerasë/kontrata e furnizimit shoqëruar si më poshtë:
4. -QKL-Leje Mjedisi të tipit B, Kodi:III.1.B “Për impiant betoni, prodhimin e produktve të betonit, shoqëruar me planvensodjen për impiantin.

F. Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar, si më poshtë vijon duhet të disponojë :

- Kokore, minimumi 70 copë;
- Jeleke Fosfoeshente, minimumi 70 copë;
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 5 copë;
- Prozhektorë ndriçimi natën, minimumi 5 copë;
- Kompleti ndimës së shpejtë, minimumi 5 copë;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, minimumi 20 copë.

Është e mjaftueshme paraqitja e vetëdeklarimit *sipas Shtojcës.8 të DST-së.*

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet

kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.4.1 Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të vetëdeklaruar (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese) *sipas Shtocës Nr. 8 të DST-së*. Në rast deklarimi të rremë, do të veprhet në përputhje të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

2.4.2. Operatori/et ekonomik ofertues, duhet të deklarojë që, të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara në pikën 2.3.20 të Kapacitetit Teknik, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera, afati i zbatimit të të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt prokurimi, **janë shkak skualifikimi**. Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve, si gjatë vlerësimit të ofertave, ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në rast deklarimi të rremë, do të veprhet në përputhje të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”:

2.4.3 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë çertifikatat (të vlefshme) si më poshtë:

- **Çertifikatë S SH EN-ISO 9001-2015** ose ekuivalenti i tij (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë, e vlefshme*). Në rast bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).
- **Çertifikatë S SH EN-ISO 14001-2015** ose ekuivalenti i tij (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit, e vlefshme*). Në rast bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).
- **Çertifikatë SSH ISO 45001:2018** ose ekuivalenti i tij (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e vlefshme*). Në rast bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).

* Të gjitha çertifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, çdo anëtar i grupit, duhet të paraqesë përkatësisht Çertifikatën ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Akt – Marrëveshjes).

Nëse ofertuesi do të paraqitet si Bashkim Operatorësh, çertifikatat duhet të jenë në përputhje me punimet e marra sa më sipër.

Në rastet e bashkimit të O.E, secili nga anëtarët e bashkimit të grupit duhet të plotësojë kërkesën e mësipërme, në përputhje me zërat e punimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas Akt Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

Argumentimi: Referuar VKM-së nr. 285, datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”, pika 1 si dhe Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 79, Autoriteti Kontraktor, ka të drejtë të kërkojë certifikata të lëshuara nga një organ i akredituar ose organizma ndërkombëtarë, me qëllim që, operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën, të jenë certifikuar në sistemet e menaxhimit të cilësisë, të mjedisit, të shëndetit dhe sigurisë në punë si dhe menaxhimin e integruar, në përputhje me objektin e kësaj kontrate dhe e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë.

Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Autoriteti Kontraktor, përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime të zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve. Kjo certifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi, kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve.

2.4.4 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materiale elektrike
- Materialet hidraulike
- Materiale gipsi
- Materiale durale
- Materiale hidroizoluese
- Materiale termo-izoluese (Sistem Kapote)
- Pajisje hidrosanitare
- Bordura Betoni
- Pllaka, Parket, Lminat
- Bojra

Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik ta vertetojë këtë duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marreveshje lidhur mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar, si dhe cdo dokumentacion tjetër ligjor të vlefshëm që provon lidhjen e distributorit të autorizuar me prodhuesin”.

Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin perkates për produktet e meposhtme duhet te paraqiten

- a- Boje Hidroplastike** ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 **ose ekuivalente**, lidhur me emetimin e komponentëve organikë të paqëndrueshëm (VOC), ku emetimi të jetë jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C < 1000µg/m³. - SSH EN ISO 6504-3:2007 **ose ekuivalente**, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.- SSH EN ISO 11998:2006 **ose ekuivalente** lidhur me rezistencën ndaj fërkimit të lagësht, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e II-të. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimi nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente Certifikim ku të vërtetohet se produkti eshte boje ekologjike dhe antibakteriale.**
- b- Bojë hidromat** Boja hidromat të jetë me bazë rezinë vinilike, e cila shërben për përdorim të brendshëm, për sipërfaqe muresh apo tavanesh. Të ketë mbulim të mirë dhe aplikim të lehtë Natyra e lidhësit: Kopolimer (rezinë) vinilike Viskoziteti: 100 ± 20 KU (Krebs-Stormer method)**ose ekuivalente** Norma e hapjes: > 15m² / litër (me një shtresë trashësi filmi 80-100µm), Pësia specifike: 1.5 ± 0.2 kg/litër Standartet Teknike që duhet të përmbushë: Përmbajtja e VOC (komponentët organikë të paqëndrueshëm): ≤ 10g/l sipas Vendimit të Komisionit Europian datë 28 Maj 2014 “*Për vendosjen e kriterëve ekologjike për dhënien e etiketës ekologjike të BE-së për bojërat dhe llaqet e brendshme dhe të jashtme.* **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me raportet e testimi nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.**
- c- Laminat** per mbulimin e dyshemese per perdorim te brendshem Trashesia 8-10 mm Reagimi ndaj zjarrit Cfl-s1 Rezisteca termike 0,115 m2K/Ë Rezistenca rrotulluese - asnjë ndryshim/dëmtim i dukshëm pas 2500 rrotullimeve Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 14041:2008 **ose ekuivalente.****Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**
- d- Pllakë shtrimi grez porcelanato.** Formati 60/60 cm x 10mm, Porcelain . Nuk duhet të jenë të lëmuara në mënyrë që të shmanget rrëshqitja. Duhet të jenë rezistente ndaj gërvishtjeve (kategoria 4) dhe të kenë koeficientin më të lartë të mundshëm kundër rrëshqitjes. **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te shoqeruara me Certifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata Performance leshuar nga prodhuesi.**
- e- Sistem Kapote** Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike te kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 13499 **ose ekuivalent.** **Duhet te paraqiten:Kataloget/skedat teknike te produkteve perberese te sistemit e shoqeruar me Certifikate Cilesise nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente.**

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave që do të ofertojnë, është kërkesë ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, apo marrëveshje bashkëpunimi, duke treguar origjinalitetin e tyre dhe ofruar garanci për mallrat që do të furnizohen.

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës së prokurimit, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës.

Gjithashtu OE duhet të paraqesin skedat teknike/katalogë për disa prej artikujve kryesor të objektit të prokurimit, ku të shprehin qartë secilin lloj të mallit që ofertojnë, për të gjykuar nëse malli që do të lëvrohen nga operatorët ekonomikë janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe se OE do të furnizojë me ato mallra që ka paraqitur në ofertën e tenderit dhe për të cilën do të jetë shpallur fitues. Kërkesa për skedat teknike/katalogë është vendosur për pajisjet që kanë një rëndësi të veçantë për AK dhe një vlerë të konsiderueshme.

2.5 Operatori/ët Ekonomik ofertues duhet të paraqesin:

2.5.1 Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (**Bashkëlidhur DST-së**), të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

2.5.2 Planin e organizimit të punimeve të objektit ku të reflektojë të gjitha masat tekniko-organizative dhe elementët e tjerë që kërkon një plan organizimi i mirëfilltë.

Argumentimi: Këto kërkesa janë vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39.

2.5.3 Sipas preventivit, kontrata e tubove D-63mm të jetë e shoqëruar me kontratë furnizimi, katalogun, ISO 9001-2015, të dhënat teknike, makineritë e prodhimit të tubove, QKB, certifikata e cilësisë së provës, Kodi III.1.B (riciklim plastik ,), Kodi III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), Kodi III.2.B (përpunimi i plastikës).

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave që do të ofertojnë, është kërkesë ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, apo marrëveshje bashkëpunimi, duke treguar origjinalitetin e tyre dhe ofruar garanci për mallrat që do të furnizohen.

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës së prokurimit, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës.

Gjithashtu OE duhet të paraqesin skedat teknike/katalogë për disa prej artikujve kryesor të objektit të prokurimit, ku të shprehin qartë secilin lloj të mallit që ofertojnë, për të gjykuar nëse malli që do të lëvrohen nga operatorët ekonomikë janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe se OE do të furnizojë me ato mallra që ka paraqitur në ofertën e tenderit dhe për të cilën do të jetë shpallur fitues. Kërkesa për skedat teknike/katalogë është vendosur për pajisjet që kanë një rëndësi të veçantë për AK dhe një vlerë të konsiderueshme.

2.5.4 Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në **gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës)**, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar “Apostile”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

2.5.5 Vetëdeklarimi nga Operatori/et Ekonomik që brenda të njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me një vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më e madhe se 100% i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas liçencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “Periudhë”, nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-paraqitjes të një dokumenti, ose të dokumentave false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.